



Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



15 years  
Western Balkans  
Investment Framework  
WBIF  
BUILDING THE EUROPEAN FUTURE TOGETHER  
BLENDING  
PUBLIC  
PRIVATE  
GUARANTEES

# OPEN<sup>4</sup> BUSINESS

Biznesi në Ballkanin Perëndimor  
me mbështetje të Bashkimit Evropian

Financimet për ndërmarjet  
e vogla dhe të mesme  
Kreditë - Kapitale - Grandet -  
Shërbimet këshillimore

JANAR 2025

# FINANCIMI DHE GARANCIA

Vështrim i programeve aktive të  
WBIF për sektorin privat

Në bashkëpunim me



# FINANCIMI DHE GARANCIA

## Vështtrim i WBIF programeve aktive për sektorin privat

Zhvillimi i një sektori privat të fuqishëm është me rëndësi thelbësore për zhvillimin dhe integrimin socio-ekonomik rajonal, si dhe për përmirësimin e konkurrencës dhe hapjes së vendeve të reja të punës në rajon. Plani ekonomik dhe i investimeve (EIP) për Ballkanin Perëndimor përqëndrohet në rëndësinë e mbështetjes së

startape-ve, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MMSP) si mjete për arritjen e këtij qëllimi dhe drejton investime të konsiderueshme drejt inovacionit dhe rritjes së gjelbër. Për të përmirësuar potencialin e sektorit privat, Bashkimi Evropian (BE) ka rritur financimin e disponueshëm për kombinimin

e grandeve (fondet e pakthyeshme), kredive dhe garancive në kuadër të fondit të Garancisë për Ballkanin Perëndimor (EFSD+). Në këtë mënyrë përforcohen ekosistemet e hapura inovative dhe miqësore për biznesin për MMSP-në në rajon.



### Rezultatet kyçe

Nga viti 2009.

**€628m**  
të mjeteve të Bashkimit Evropian mjete për MMSP-në në Ballkanin Perëndimor

**€7,0bn**  
investimet e vlerësuara

**395.307**  
MMSP të mbështetura

**1.126.578**  
të mbështetura dhe/ose vende pune të ruajtura

**1,6m MWh p.a.**  
energji e kursyer

**592.096 t/p.a.**  
emetimet e reduktuara të CO2

**Fondi i garancisë për Ballkanin Perëndimor**

**deri në €985m**  
mbulim të garancisë

**deri në €49,6m**  
ndihmë teknike



BE-ja ka ndihmuar MMSP-në të përmbush standardet e BE-së në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, shëndetsisë dhe sigurinë në punë, si dhe cilësisë dhe sigurisë së produktit, duke u mundësuar atyre që të jenë konkurrues në tregun unik të BE-së.

### Prioritet e EIP

në përputhje me EIP-sin, Prioritetet kyçe të BE-së për zhvillimin e sektorit privat në Ballkanin Perëndimor janë:

Tranzicioni i gjelbër

Bujqësia e qëndrueshme

Tranzicioni digjital dhe inovacion

Integrimi tregtar dhe i zinxhirit të vlerave

Qasja financiare

Diversifikimi financiar

Tërheqja e kapitalit privat

Shumëtematike

Programet për të lehtësuar aksesin në financimin e MMSP-së	Prioriteti
<b>Programi i gjelbër për MSP-në në Ballkanin Perëndimor</b>	Bujqësia e qëndrueshme
	Tranzicioni i gjelbër
<b>Financa e gjelbër për përfshirjen</b>	Qasja financiare
	Bujqësia e qëndrueshme
<b>Digjitalizimi në Ballkanin Perëndimor</b>	Tranzicioni i gjelbër
	Tranzicioni digjital dhe inovacion
<b>Parqet eko-industriale në Ballkanin Perëndimor – Prova e konceptit të</b>	Tranzicioni i gjelbër
	Integrimi tregtar dhe i zinxhirit të vlerave
<b>Programi Pilot për Prokurime gjithëpërfshirës dhe shoqërisht të përgjegjshëm</b>	Qasja financiare
<b>Reformat Strukturore – Prioritetet e Politikës së Konkurrencës për Ballkanin Perëndimor</b>	Tranzicioni digjital dhe inovacion
<b>Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE)</b>	Qasja financiare
	Bujqësia e qëndrueshme
<b>Fondi për Rritje të Gjelbërt (GGF)</b>	Tranzicioni i gjelbër
	Qasja financiare
<b>Fondit të Zgjerimit të Ndërmarrjeve (ENEF II)</b>	Diversifikimi financiar
<b>Programi Rajonal i Mbështetjes së Konkurrencës të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Ballkanin Perëndimor</b>	Integrimi tregtar dhe i zinxhirit të vlerave
	Tranzicioni i gjelbër
<b>Këshillime për Ndërmarrjet e Vogla</b>	Shumëmatike
<b>WB EDIF një garanci për rezistencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme</b>	Qasja financiare
	Diversifikimi financiar
<b>Rritja për të gjithë</b>	Qasja financiare
<b>HI-BAR</b>	Tërheqja e kapitalit privat
	Tranzicioni i gjelbër
<b>Mbështetja e transformimit të gjelbër të orientuar nga tregu në Fqinjësinë Lindore dhe Ballkanin Perëndimor</b>	Tërheqja e kapitalit privat
	Tranzicioni i gjelbër
<b>Programi i Klimës për Ballkanin Perëndimor</b>	Tranzicioni i gjelbër
	Diversifikimi financiar
<b>Faciliteti për Inovacion dhe Transformim të Gjelbër</b>	Tranzicioni digjital dhe inovacion
	Tranzicioni i gjelbër
<b>Mbështetja e Sipërmarrësve dhe MSMEs për të Mbrojtur Punësimin</b>	Qasja financiare
<b>EDFI Carbon Sinks</b>	Tërheqja e kapitalit privat
	Tranzicioni i gjelbër

## Programi i gjelbër për MSP-në në Ballkanin Perëndimor

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2022</b>	Totali i grandit të WBIF-it**: <b>€25 milionë</b>	<b>Bujqësia e qëndrueshme</b>	<b>Tranzicioni i gjelbër</b>
	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€145 milionë</b>		
"Programi i gjelbër për MSP-në në Ballkanin Perëndimor" të cilin e udhëheq banka Evropiane për Rinovim dhe Zhvillim (BERZH) fokusohet në përparimin e ekonomisë qarkulluese dhe të gjelbër, agrobiznesit dhe investimit në konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (MSP) në Ballkanin Perëndimor.	Programi është i dizajnuar me strategji për t'u fokusuar në: <ul style="list-style-type: none"> <li>Zgjerimin e investimeve në ekonominë e gjelbër duke alokuar te pakten 70% te investimeve totale në teknologjitë e gjelbërta</li> <li>Mbështetjen e bujqësisë dhe zinxhirëve të vlerës duke i kushtuar këtij sektori 33% të totalit të investimeve</li> <li>Sigurimi i një qasjeje më të ekuilibruar ndaj financimit klimatik për MSP-në duke alokuar te pakten 25% të investimeve, te cilat do të drejtohen në nismat e udhëhequra nga gratë.</li> </ul>	BERZH-i ofron financim afat-gjatë për MSP-në nëpërmjet institucioneve financiare lokale për investime të kualifikuar. Këto linja krediti mbështeten nga shërbimet këshillimore të financuara nga BE dhe MSP-të mund të presin një rimbursim pas përfundimit dhe verifikimit të suksesshëm të investimeve.		

## Financa e gjelbër për përfshirjen

Përfituesit: Shqipëria dhe Serbia	Data e fillimit: <b>Janar 2023</b>	Totali i grandit të WBIF-it: <b>€10 milionë</b>	<b>Bujqësia e qëndrueshme</b>	<b>Qasja financiare</b>
	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€130 milionë</b>		
Lironi potencialin të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të përfaqësuara me pamjaftueshmëri (MMSP) në të gjithë Ballkanin Perëndimor me programin "Financa e gjelbër për përfshirjen." Me investimin në masat inovative të efikasitetit të energjisë dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike, ky program do të nxisë ndryshime transformuese. Mbështetja është veçanërisht e fokusuar në fuqizimin e MSME-ve të udhëhequra nga gratë dhe të rinjve në sektorët e ndërmarrjes sociale, bujqësisë së mirëmbajtur, ekonomisë rrethore dhe ekoturizmit.	Cassa Depositi e Prestiti (CDP) është një institucion kryesor financiar që ofron linja krediti për institucionet financiare lokale, duke i përfshirë institucionet mikrofinanciare (MFI), për ti lehtësuar dhenien e kreditive të MMSP-së me kushte të favorshme.	Falë mbështetjes së BE-së, MMSP-të e kualifikuar mund të kenë akses në kredi me kushte të volitshme si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> <li>norma me te ulura interesi,</li> <li>kërkesa të reduktuara për kolateral,</li> <li>afate më të gjata ripagimi,</li> <li>kombinimi i l të gjithave sa me siper.</li> </ul>		

## Digjitalizimi në Ballkanin Perëndimor

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2023</b>	Totali i grandit të WBIF-it: <b>€27,6 milionë</b>	<b>Tranzicioni digjital dhe inovacion</b>	<b>Tranzicioni i gjelbër</b>
	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€177,6 milionë</b>		
Programi "Digjitalizimi në Ballkanin Perëndimor" e mbështet digjitalizimin, automatizimin dhe konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (MSP) në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Duke theksuar qëndrueshmërinë, së paku 50% të investimeve do të drejtohen në projektet e gjelbëra, derisa së paku 30% do të drejtohen në rajonet jashtë kryeqyteteve, gjë që do të kontribuojë në zhvillimin rajonal dhe rural.	BERZH-i siguron financim afatgjatë për MSP-të nëpërmjet institucioneve financiare lokale për investime të kualifikuara. Këto linja krediti mbështeten nga shërbimet këshillimore të financuara nga BE, ndërsa MSP-të mund të presin një kthim të hollave pas përfundimit të suksesshëm dhe verifikimit të investimeve. Iniciativat do të fokusohen kryesisht në teknologjitë e avancuara që janë më pak të pranishme në treg, duke ulur kostot fillestare.	Disa nga teknologjitë digjitale të kualifikuara përfshijnë zgjidhje të automatizuara te prodhimit, realitetin e shtuar, tregtine elektronike, të dhëna të mëdha dhe analitikë, dhe shumë më tepër. Investimet në automatizim do të përfshijnë pajisjet e prodhimit dhe te procesit, shtypjen, pajisjet bujqësore dhe fusha të tjera.		


\* Ky përcaktim nuk i vë në dyshim qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

\*\* Bëhet fjalë për fondet nga thirrja e WBIF për financimin e sektorit privat, si dhe për alokimet e mëparshme të Bashkimit Evropian, të cilat u konsoliduan në vitin 2020 në kuadër të WBIF-it.

### Parqet eko-industriale në Ballkanin Perëndimor - Dëshmi e konceptit

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Korrik 2023</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€3,6 milionë</b>	<b>Integrimi i tregtisë dhe i zinxhirit të vlerës</b> <b>Tranzicioni i gjelbër</b>
 <b>IFC</b> International Finance Corporation	Statusi: <b>Në zbatim</b>		
Ky është programi i parë në Ballkanin Perëndimor që zbaton konceptin e parqeve ekologjike industriale (EcoIP). Qëllimi është të demonstron zbatueshmëria e EcoIP-it duke nisur katër projekte pilot në parqet industriale në rajon.	Programi ka dy komponentë: • Komponenti i parë: IFC-ja do të kryejë vlerësimin e parqeve industriale në Ballkanin Perëndimor. Bazuar në kriteret e parapercaktuara, do të identifikohen katër parqe industriale që tregojnë potencialin më të madh për një transformim të suksesshëm në EcoIP. Ato katër parqet do të përdoren si studime të rasteve pilot dhe do të fillojnë procesin e përshtatjes.	• Komponenti i dytë përfshin një seri studimesh pilot të projektuar për të lehtësuar aplikimin e kornizës EcoIP, duke përfshirë: • Ligjerata, seminare dhe trajnime mbi zbatimin e kornizës EcoIP; • Prezantimi i praktikave më të mira ndërkombëtare për kalimin nga parqet industriale tradicionale në ato eko-industriale; • Paraqitja e një shembulli të aplikimit të kornizës EcoIP nga një studim rasti pilot.	


### Programi pilot për prokurime gjithëpërfshirës dhe shoqërisht të përgjegjshëm

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2022</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€2,5 milionë</b>	<b>Oasja financiare</b>
 <b>European Bank</b> for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në zbatim</b>		
Ky program do të ndihmojë sektorin privat në të gjithë Ballkanin Perëndimor në zbatimin e konceptit të prokurimit gjithëpërfshirës dhe me përgjegjësi sociale. Koncepti do të testohet në një projekt rajonal të menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Maqedoninë e Veriut.	Programi përbëhet ngakomponentë: 1. Hartimi i politikave përkatëse në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Kjo përfshin zhvillimin e kontratave model për të integruar elemente përfshirëse dhe elementeve të përgjegjshme shoqërore në procesin e prokurimit. 2. Pas kësaj do të vijoj trajnimi, dizajnimi dhe implementimi i konceptit të prokurimit gjithëpërfshirës dhe me përgjegjësi shoqërore për projektin e përzgjedhur të investimit.	Si rezultat, programi pritet të zhvillojë aftësi dhe mundësi punësimi për grupet aktualisht të nënpërfaqësuar në sektorin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Maqedoninë e Veriut. Një strategji gjithëpërfshirëse monitorimi, vlerësimi dhe mësimi do t'u lejojë partnerëve të nxjerrin mësim nga projekti pilot dhe të riprodhojnë qasjen mbi investimet e ardhshme në kuadër të WBIF-it.	


### Reforma strukturore - Prioritetet e politikave të konkurrencës për Ballkanin Perëndimor


Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2023</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€3 milionë</b>	<b>Tranzicioni digjital dhe inovacion</b>
 <b>European Bank</b> for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në zbatim</b>		
BERZH-i do të zhvillojë dhe zbatojë një program të plotë politikash për përmirësimin e konkurrencës së sektorit privat përfshirë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MMSP) brenda kuadrit të Reformës Strukturore - Prioritetet e Politikës së Konkurrencës për Ballkanin Perëndimor.	Programi është strukturuar në dy faza: 1. Përgatitja e raporteve mbi prioritetet e politikave të konkurrencës që vlerësojnë mundësitë dhe pengesat kryesore të rritjes në sektorin privat dhe japin rekomandime për masa korrigjuese.	2. Zbatimi i masave korrigjuese për të zgjidhur pengesat e identifikuar dhe për të përmirësuar kuadrin rregullator, fuqinë institucionale dhe mjedisin e përgjithshëm të biznesit në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me rekomandimet e raportit.	

### Fondi European për Evropën Juglindore (EFSE)

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Qershor 2006</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€109,9 milionë</b>	<b>Oasja financiare</b> <b>Bujqësia e qëndrueshme</b>
 <b>KFW</b>	Statusi: <b>Në v zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>rreth €3,6 miliardë</b>	
Zbuloni mundësitë e financimit me Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE), me forcë shtytëse për bizneset mikro dhe të vogla (MMP), për fermerët dhe bizneset familjare private.	EFSE ofron mbështetje përmes mikrofinancimit përmes bankave tregtare vendore, institucioneve mikrofinanciare dhe entiteve jobankare. Përveç financimit, Fondi i Zhvillimit EFSE forcon ndërmjetësit financiarë vendas, sektorët financiarë dhe rrit rezistencën e tyre.  EFSE Akademia e ndërmarrjes bashkëpunon me inkubatorë dhe përshtetues lokalë për të ofruar trajnime, burime, mentorim, mundësi rrjetëzimit dhe më shumë.	Rreth EFSE-së:  EFSE-ja është nisur në vitin 2005. nga ana e bankës zhvilluese të Gjermanisë, KfW, me mbështetjen e Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë (BMZ) dhe Komisionit Evropian (EK). Misioni i EFSE-së është që të nis zhvillimin ekonomik dhe të përmirësoj jetën në Evropën Juglindore dhe në Fajnesin Lindor. Si një partneritet publik-privat pionerik, EFSE-ja grumbullon burime për ndikim afat-gjatë.  Për më shumë informacion mbi Fondi Evropian për Evropën Juglindore, ju lutemi vizitoni: <a href="http://www.efse.lu">www.efse.lu</a>	

### Fondi për Rritje të Gjelbërt (GGF)

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2009</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€88,6 milionë</b> Mbështetje teknike: <b>€4 milionë</b>	<b>Tranzicioni i gjelbër</b> <b>Oasja financiare</b>
 <b>KFW</b>	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>rreth €762 milionë</b>	
Përfundimi i fuqisë së ndryshimit me Fondi për Rritje të Gjelbërt (GGF), Fondi pionerik për financimin e efikasitetit të energjisë dhe projekteve të energjisë së ripërtëritshme të cilat i realizojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MMSP) dhe amvisëritë. GGF siguron financim nëpërmjet institucioneve financiare lokale ose investime direkte në projekte dhe kompani të kualifikuara.	Përveç financimit, GGF ofron mbështetje teknike përmes shkëmbimit të njohurive dhe ekspertizës teknike, duke siguruar kështu suksesin e investimeve.  Në vitin 2023, BE-ja vazhdoi të mbështesë GGF-në me një rritje kapitali prej €20 milionë në formën e kapitalit aksionar të klasit C, e shoqëruar me €4 milionë ndihmë teknike. Ky financim shtesë do të ndihmojë në ndërtimin dhe zgjerimin e qëndrueshëm të ofertës së financimeve efektive për masat e energjisë së rinovueshme dhe efikase në rajon, si dhe do të kontribuojë në uljen e konsumit të energjisë dhe emetimeve të gazeve serrë ndërmjet huamarrësve përfundimtarë.	Rreth GGF-së:  Fondi është i nisur në vitin 2009. nga ana e bankës Evropiane të investimeve (EIB) dhe bankës Gjermane të zhvillimit (KfW) me mbështetjen e Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë (BMZ) dhe komisionit Evropian (EK). GGF-ja aktualisht është aktive në 19 tregje, përfshirë Ballkanin Perëndimor, dhe është e angazhuar për të luftuar ndryshimet klimatike, për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme.  Për më shumë informacion rreth Fondi për Rritje të Gjelbërt, ju lutemi vizitoni: <a href="http://www.ggf.lu">www.ggf.lu</a>	


Fondit të Zgjerimit të Ndërmarrjeve (ENEF) II			Diversifikimi i financiar
Përfutesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2021</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€30 milionë</b>	
 European Bank for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€75 milionë</b>	
ENEF-i inkurajon zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (MSP) dhe ndërmarrjet e kapitalizmit mesatar të tregut (Mid-caps) në Ballkanin Perëndimor. I fokusuar në sigurimin e kapitalit, dhe gati të kapitalit dhe financimit afatgjatë, ENEF II ofron mbështetjen financiare që bizneset e vogla kanë nevojë për t'u rritur dhe zgjeruar. I nisur në Dhjetor të vitit 2021.	Me mbështetjen e Komisionit Evropian, BERZH-it dhe institucioneve të tjera financiare të zhvillimit, pritet të vihen në dispozicion nëpërmjet ENEF-it deri në 75 milionë euro.  Përveç financimit, ENEF II ofron mbështetje të gjerë para dhe pas investimit, duke përfshirë identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve, si dhe shfrytëzimin e mundësive në fushat e mjedisit jetësor, përgjegjësisë sociale dhe qeverisjes së ndërmarrjeve (ESG).	<i>ENEF: një trashëgimi e dëshmuar</i>  <i>Fondit të Zgjerimit të Ndërmarrjeve (ENEF) u lançua në vitin 2014 nën Instrumentit për Sipërmarrje dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor (WB EDIF), me një kapital fillestar prej 48,5 milionë euro. E udhëhequr nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ENEF I ka investuar me sukses në 16 kompani deri në korrik të vitit 2020.</i>	

Programi rajonal për të mbështetur konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor			Integrimi i tregtisë dhe zinxhirit të vlerës	Tranzicioni i gjelbër
Përfutesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2017</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€30 milionë</b>		
 European Bank for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€170 milionë</b>		
"Programi rajonal për mbështetjen e konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (MSP) në Ballkanin perëndimor" e përforcon MSP-në të për të konkurruar në tregun e BE-së duke përmbushur standardet e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe standardet e cilësisë dhe sigurisë së produktit.	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) siguron financim afatgjatë për investimet e pranueshme nëpërmjet institucioneve financiare vendase. Këto linja krediti mbështeten nga shërbime këshillimore të financuara nga BE-ja, duke siguruar që bizneset të jenë të pajisura mirë për të përmbushur standardet strikte. Kthimi i të hollave deri në 15% është në dispozicion të MSP-së pas përfundimit dhe verifikimit të suksesshëm të investimeve.	<i>Për më shumë informacion mbi Programi rajonal për të mbështetur konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor, ju lutemi vizitoni: <a href="http://web-sme-csp.com">web-sme-csp.com</a></i>		

Këshillime për Ndërmarrjet e Vogla			Shumëmatike
Përfutesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2019</b>	Totali i grantit të WBIF-it: <b>€15 milionë</b>	
 European Bank for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në zbatim</b>		
Programi "Këshillime për Ndërmarrjet e Vogla" ofron shërbime këshillimi gjithëpërfshirëse që mbulojnë strategjinë dhe operacionet, menaxhimin e cilësisë, raportimin financiar, efikasitetin e energjisë dhe më shumë.	Programi funksionon përmes një rrjeti ekspertësh vendas dhe ndërkombëtarë, duke ofruar akses në praktikë më të mirë, më të avancuara. Misioni është i qartë - pajisja e bizneseve të vogla në Ballkanin Perëndimor me mjete për të përmirësuar performancën e biznesit dhe për të rritur konkurrencën.	<i>Për më shumë informacion mbi programin Këshillime për Ndërmarrjet e Vogla, ju lutemi vizitoni:</i>  <a href="https://www.ebrd.com/small-business-support/advice-for-small-businesses.html">https://www.ebrd.com/small-business-support/advice-for-small-businesses.html</a>	

WB EDIF një garanci për rezistencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme			Diversifikimi i financiar	Oasia financiare
Përfutesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Qershor 2022</b>	Mbulimi total i garancisë: <b>deri në €60 milionë</b>		
 European Investment Fund	Statusi: <b>Në vijim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>rreth €750 milionë</b>		
Kjo Garancia, fuqizon ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSP) në Ballkanin Perëndimor përmes qasjes së përmirësuar në fondet financiare të volitshme. Duke ndarë rrezikun me bankat komerciale, garancia i dedikohet mbështetjes së MSP-ve më të vogla, me një alokim minimal prej 25% për mikro-ndërmarrjet.	Falë mbështetjes së BE-së, MSP-të e kualifikuara mund të kenë qasje në kredi me kushte të volitshme si që janë: • norma më të ulëta interesi • kërkesa të reduktuara për kolateral • afatet më të gjata të shlyerjes • kombinimi i kushteve të përmendura.	E nisur në Qershor të vitit 2022 si përgjigje ndaj pandemisë së virusit COVID-19 dhe krizës energjetike, kjo iniciativë u ndihmon MSP-ve të forcojnë rezistencën e tyre derisa lëvizin drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe me emetim të ulët të karbondioksidit.		

Rritje për të gjithë			Oasia financiare
Përfutesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Gusht 2024</b>	Mbulimi total i garancisë: <b>deri në €40 milionë</b>	
 European Bank for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në vijim</b>	Mbështetje teknike: <b>deri në €4 milionë</b>	
Garancia "Rritja për të gjithë" adreson disa nga sfidat kryesore me të cilat përballen ndërmarrjet mikro dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor duke mundësuar financime të specializuara dhe mbështetje teknike që nxisin rritjen e qëndrueshme ekonomike në segmentet e mbështetjes së pamjaftueshme dhe nxisin ndryshimet afatgjata.	Financimi do të jetë i disponueshëm përmes institucioneve financiare lokale në të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe do të ketë kahun në mënyrë specifike për ndërmarrjet bujqësore dhe ato të drejtuara nga gratë dhe të rinjtë.  Garancia është përpiluar për të motivuar ndërmjetësuesit financiarë për të financuar segmente të synuara që konsiderohen shumë të rrezikshme, duke u siguruar atyre linja kredie të mbuluara nga një garanci për një pjesë të humbjeve të pësuar.	Mbështetja teknike që përfshin ngritjen e kapaciteteve të ndërmjetësve financiarë, mbështetjen e drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve bujqësore, marketingun dhe verifikimin e kriterëve të pranueshmërisë së investimeve do të jetë kyçe për zbatimin me sukses të programit dhe arritjet e qëllimeve të tij.	

HI-BAR			Tranzicioni i gjelbër	Tërheqja e kapitalit privat
Përfutesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Marsi 2024</b>	Mbulimi total i garancisë: <b>deri në €50 milionë</b>		
 European Bank for Reconstruction and Development	Statusi: <b>Në vijim</b>	Mbështetja teknike: <b>deri në €2,5 milionë</b>		
Kjo EFSD+ HI BAR garancia i përshpejton investimet në gjeneratën e ardhshme të masave për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe modeleve të biznesit në sektorin energjetik dhe në industrinë me energji intensive. Këto investime përfshijnë një tranzicion më të shpejtë drejt energjisë së gjelbër, përmirësimin e sigurisë energjetike, diversifikimin e burimeve të energjisë dhe një zhvendosje nga varësia e jashtme nga lëndët djegëse fosile.	Garancia do të mbështesë zbatimin e teknologjive të pjekura që nuk kanë arritur nivele kritike të adoptimit për shkak të pengesave në zhvillimin e tregut ose mungesës së tregjeve të vendosura të energjisë. Pos kësaj, HI-BAR do të mundësojë investime në "gjeneratën e ardhshme" teknologjive klimatike që përballen me rreziqe të larta teknologjike dhe kërkojnë "premiumin e gjelbër" të konsiderueshëm për shkak të mungesës së një tregu të vendosur.	Garancia në afat të shkurtër, mund të sigurojë gjithashtu një nivel të lartë mbulimi për kërkimin mbi lëndët e para kryesore që shërbejnë si inpute parësore për teknologji të ndryshme klimatike në të ardhmen. Përdoruesit përfundimtarë të financimit do të jenë kompanitë publike, korporatat private dhe -bashkitë.		

### Mbështetja mbështetje për transformimin e gjelbër të orientuar drejt tregut tek Fqinjët Lindor dhe Ballkanit Perëndimor

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Qershor 2024</b>	Mbulimi total i garancisë: <b>deri në €200 milionë</b>	Tranzicioni i gjelbër Tërheqja e kapitalit privat
<b>KFW</b>	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Mbështetje teknike: <b>deri në €10 milionë</b>	
Kjo EFSD+ garancia mbështet transformimin e gjelbër të orientuar drejt tregut në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>përmirësimi i aksesit në financim për ndërmarrjet publike dhe korporatat private për të mundësuar investime shtesë</li> <li>përmirësimi i gatishmërisë në treg të ndërmarrjeve publike nëpërmjet forcimit institucional dhe komercializimit</li> <li>promovimi i integritimit të tregut rajonal të energjisë elektrike brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe me BE-në.</li> </ul>	Garancia do të mundësojë investime në kapacitete shtesë të energjisë së ripërtëritshme (RE) për projektet diellore dhe të erës, rehabilitimin e hidrocentraleve, rrjetet inteligjente dhe magazinimin, masat e efikasitetit të energjisë (EE) dhe investime të tjera të nevojshme për të forcuar transformimin gjithëpërfshirës të gjelbër.	Përdoruesit përfundimtarë të financimit për investime në burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe infrastrukturën e rrjetit do të jenë publikë shumë shpejt. Këto kompani do të përfitojnë nga kreditimi i drejtpërdrejtë me kushte të volitshme, gjë që sjell pavarësi më të madhe në marrjen e vendimeve të korporatave, duke i afruar ato me tregjet.	

### Programi i Klimës për Ballkanin Perëndimor

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2024</b>	Totali i grandit të WBIF-it: <b>€17,2 milionë</b>	Diversifikimi financiar Tranzicioni i gjelbër
<b>IFC</b>	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€207,2 milionë</b>	
Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga nivele të larta të intensitetit të energjisë, nivele të larta të ndotjes dhe një përzierje energjie të dominuar nga lëndët djegëse fosile.	Përveç hendekut të financimit të klimës, tregjet e kapitalit në Ballkanin Perëndimor mbeten të pazhvilluara, me financim në monedhë lokale afatmesme deri afatgjatë pothuajse inekzistente. Për të adresuar disa nga këto sfida, "Programi i Klimës për Ballkanin Perëndimor" financon nën-kredi të lidhura me ndryshimet klimatike që mbështesin kalimin nga ekonomitë me karbon të lartë në ato me karbon të ulët. Programi do të rrisë qasjen në financimin e klimës, duke përfshirë efikasitetin e energjisë dhe prodhimin e energjisë së pastër për nën-huamarrësit në rajon. Kjo do t'u mundësojë bizneseve të përmirësojnë ndikimin e tyre mjedisor duke zbatuar investime të zgjuara për klimën.	Përveç kësaj, Programi do të mbështesë zhvillimin e tregjeve të kapitalit duke emetuar bono të gjelbra. Programi do të shoqërohet me asistencë teknike për të forcuar kapacitetin e lidhur me klimën të Ndërmjetësve Financiarë Partnerë (PFIs) duke rritur ndërgjegjësimin për MSMEs dhe duke ndërtuar potencialin e PFIs për të emetuar bono të gjelbra.	

### Faciliteti për Inovacion dhe Transformim të Gjelbër

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Dhjetor 2024</b>	Totali i grandit të WBIF-it: <b>€23,7 milionë</b>	Tranzicioni i gjelbër Tranzicioni i kapitalit privat
<b>EIF</b>	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Investimi i vlerësuar: <b>€363,7 milionë</b>	
Faciliteti për Inovacion dhe Transformim të Gjelbër mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs) dhe Mid-Caps inovative dhe disa nga investimet e tyre të gjelbra në Ballkanin Perëndimor. Të paktën 70% e Facilitetit do të dedikohet për investime në produkte dhe procese inovative, kërkim, zhvillim dhe inovacion (RDI), dhe kompani të drejtuara nga inovacioni. Pjesa e mbetur prej 30% do të alokohet për investime në zbutjen e ndryshimeve klimatike,	kryesisht në bujqësi, adaptim dhe projekte të tjera të gjelbra. Të paktën 80% e përfituesve përfundimtarë do të jenë SMEs, ndërsa pjesa e mbetur prej 20% do të jenë Mid-Caps. EIF ofron financim me borxh për SMEs dhe Mid-Caps përmes bankave komerciale lokale për investime kualifikuese. Këto linja krediti përforcohen nga stimujt e kthimit të parave të financuara nga BE që presin përfituesit përfundimtarë/final pas përfundimit dhe verifikimit të suksesshëm të investimeve.	SMEs dhe Mid-Caps gjithashtu do të marrin asistencë teknike për të identifikuar teknologjitë dhe zgjidhjet e përshtatshme për bizneset e tyre dhe për të zhvilluar projekte investimi të financuara nga banka.	

### Mbështetja e Sipërmarrësve dhe MSMEs për të Mbrojtur Punësimin

Përfituesit: Shqipëria, Kosovë, Serbia	Data e fillimit: <b>Shtator 2024</b>	Mbulesa totale e garancisë: <b>deri në €48 milionë</b>	Qasja financiare
<b>KFW</b>	Statusi: <b>Në zbatim</b>	Mbështetje teknike: <b>deri në €2 milionë</b>	
Kjo Garanci ndihmon Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë në rimëkëmbjen pas pandemisë, duke rritur konkurrencën dhe krijimin e vendeve të punës në rajon. Përmes garancive të ndarjes së riskut dhe asistencës teknike, ajo hap financimin për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSMEs), duke i dhënë përparësi start-up-ëve, MSMEs rurale dhe atyre që operojnë në sektorin e prodhimit.	Garancia do të zbatohet përmes Fondit të Garancisë së Kredive Lokale (CGFs), i cili do t'u mundësojë Ndërmjetësve Financiarë Partnerë (PFIs) të financojnë MSMEs e synuara duke zbutur rreziqet e huadhënies përmes rimbursimit të pjesshëm të humbjeve në rast të mospaguesës së MSMEs.	Falë mbështetjes së BE-së, MSMEs e kualifikuara mund të kenë qasje në kredi me kushte të favorshme si: <ul style="list-style-type: none"> <li>norma më të ulëta interesi,</li> <li>kërkesa të reduktuara për kolateral,</li> <li>maturitete më të gjata,</li> <li>një kombinim i të gjitha më sipër.</li> </ul>	

### EDFI Carbon Sinks

Përfituesit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia	Data e fillimit: <b>Marsi 2024</b>	Mbulimi total i garancisë: <b>deri në €12 milionë</b>	Tranzicioni i gjelbër Atraktiviteti i kapitalit privat
<b>EDFI</b>	Statusi: <b>Në vijim</b>	Mbështetje teknike: <b>deri në €0,6 milionë</b>	
EDFI Karbon Sinks synon të rrisë magazinimin e karbonit dhe të zgjerojë menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe/ose kënetave duke ofruar reduktime të emetimeve me cilësi të lartë, duke rikthyer biodiversitetin dhe përmirësuar jetesën për komunitetet dhe fermerët që varen nga pyjet.	Karbon Sinks janë zgjidhje të bazuara në natyrë që thithin dioksidin e karbonit (CO2) nga atmosfera.	Investimet që përfitojnë nga Garancia do të bëhen drejtpërdrejt në kompani private të pylltarisë dhe agrobiznesit ose indirekt përmes fondeve të kapitalit dhe krediteve të karbonit. Përveç investimeve, Garancia ofron asistencë teknike për përgatitjen e projekteve për të siguruar që rreziqet mjedisore dhe sociale të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme.	